

**VENDIM**  
**Nr.140, datë 22.12.2008**

**PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË “MODELIN E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”, QË DO T’I PROPOZOHEN PËR MIRATIM KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 9 dhe të nenit 53, pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 22.12.2008, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për disa ndryshime në modelin e tregut të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008, dhe konstatoi nevojën e harmonizimit të këtij modeli tregu me ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar

**VENDOSI:**

1. Miratimin e disa ndryshimeve në “Modelin e tregut të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.339, datë 19.3.2008, të cilat do t’i propozohen për miratim Këshillit të Ministrave, me përmbajtjen si më poshtë:

A. Në pikën 4.2 paragrafi i katërt - Gjenerimi KESH Gen, hiqen fjalët “të tepërt” dhe kjo pikë bëhet me përmbajtjen si më poshtë:

“Shet energji elektrike në tregun vendas ose atë të eksportit në përputhje me rregullat dhe procedurat e shitjes së energjisë elektrike të miratuara nga ERE.”.

B. Në paragrafin e fundit të pikës 4.13, germa “A”, hiqen fjalët:  
ose rregulla prokurimi.

C. Në pikën 5.7, shitjet e KESH Gen-it te blerës të tjerë, kudo ku përcaktohet: “KESH Gen mund të shesë energji elektrike të tepërt”, të hiqen fjalët “e tepërt”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Bujar Nepravishta**